



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

C.nr.810/21

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me Gjyqtaren Mirjeta Shala, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit A.M., me vendbanim në Gj., të cilin me autorizim e përfaqëson i autorizuari Ilir Rogova, – avokat në Gjakovë, kundër të paditurës D.K.A., e përfaqësuar nga D.B., me autorizim, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe të udhëtimit në punë, vlera e kontestit 513.00 Euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik të mbajtur, në prezencën e të autorizuarit të paditëses dhe të përfaqësuesit të paditurës, me datë 17 maj 2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar në ligj kërkesëpadija e paditësit A.M. nga Gj., dhe DETYROHET e paditura D.K.A., që paditësit A.M. nga Gj., në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për periudhën kohore 15.11.2019 e deri më 29.10.2021 për 208 ditë të pranisë në punë, të i'a paguajë shumën prej 416.00 euro si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, për periudhën kohore 15.11.2019 e deri më 29.10.2021, respektivisht për 139 ditë të pranisë në punë, të i'a paguajë shumën prej 97.30 euro, përkatësisht në shumë të përgjithshme prej 513.30 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 09.06.2021 (datë e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

II. DETYROHET e paditura D.K.A., që paditësit A.M. nga Gj., të iu kompensojë shpenzimet procedurale në shumën e përgjithshme prej 259.20 euro, në afatin prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësi në këtë gjykatë me datë 09.06.2021 përmes të autorizuarit të lartpërmendur të tij, kanë parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe të udhëtimit për ditët e pranisë në punë. I autorizuari i paditësit, në seancën e shqyrtimit kryesor ka bërë precizimin e kërkesë padisë në aspektin objektiv. I

njëti në padinë e precizuar, në fjalën e dhënë në seancën e shqyrtimit kryesorë dhe në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se paditësi është punëtor i arsimit në SHFMU "E." dhe shkollën "At Gj." në fshatin B., komunan e Gjakovës. Duke qenë se të njëjti jetonë në Gj., për çdo ditë punë kanë udhëtuar nga vendbanimi i tij për në vend punimin e tij, në fshatin B., përkatësisht në SHFMU" At Gj.". Ka shtuar se e paditura deri me tani nuk është përgjigjur as në padi e as në parashtrësë dhe e njëjta nuk e ka kundërshtuar asnjë pretendim të paditëses. Kërkesa e tyre që ka të bëjë me kompensimin e parave të ushqimit dhe shpenzimeve të udhëtimit gjatë punës gjen zbatim në Kontratën kolektive të vitit 2017 dhe ajo e vitit 2021. Lartësia e kërkesës në emër të shpenzimeve të ushqimit është 2 euro për çdo ditë punë, ndërsa për shpenzimet e udhëtimit, është 1,00 në ditë, sipas vërtetimit të lëshuar nga Shoqata e Transporti të Udhëtareve. Andaj mbi këtë bazë i ka propozuar Gjykatës që kërkesëpadia e precizuar e paditëseit të aprovohet si e bazuar, ashtu që të detyrohet e paditura që paditësit për 208 ditë të pranisë në punë të realizuara, për periudhën kohore nga data 27.11.2019 e deri me datën 15.11.2019, në emër të shpenzimeve të ushqimit të ia paguaj shmën prej 416,00 euro ndërsa, në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, për 139 ditë të pranisë në punë, për periudhën e njëjt kohore, të ia paguaj shmën prej 97,30 euro, në shumën e përgjithsme prej 513.30e euro, me kamatën ligjore prej 8% duke filluar nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Shpenzimet procedurale i kërkojmë dhe atë: taksën gjyqësore për padi në vlerë prej 20,00 €, për përpilimin e padisë prej 104,00 € dhe për përfaqësim në një seancë gjyqësore nga 135,00 €, apo në shumën e përgjithshme 259.20 €.

Përfaqësuesi i të paditurës në fjalën e dhënë në seancën për shqyrtimin kryesorë të çështjes dhe në fjalën e tij përfundimtare, ka deklaruar se kontrata e kolektive e arsimit në Kosovë e nënshkruar në mes MASHT dhe SBASHK-ut me dt. 22.01.2021, në nenin 47 të saj, ka shfuqizuar Kontratën kolektive të dt.18.07.2017, ashtu edhe sipas nenit 35 par. 5 dhe par.7 të kësaj kontrate lidhur me këtë dhe dispozitat kalimtare e kërkesave lidhur me zbatimin e dispozitave të nenin 35 par. 5,7 dhe 11 deri sa të krijohen mundësit financiare në Buxhetin e R. Kosovës por jo më vonë se viti 2023, po ashtu edhe sipas Qarkores Buxhetore 2022/01 i datës 14.05.2021, të garantit specifik të arsimit para universitare, nuk është parapare mundësia për realizimin e kësaj të drejte. Andaj mbi këtë bazë i ka propozuar gjykatës që padia dhe kërkesëpadia e paditësve të refuzohet si e pa bazuar. Ndërsa lidhur me ndryshimin e padisë në aspektin objektiv, ka deklaruar se të njëjtën nuk e kundërshtoj.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim:

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore,(më tutje LPK-së), arriti në përfundim se në këtë çështje juridike konstatimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat e administruara, u vërtetua gjendja faktike si në vijim:

Nga Kontratë pune me Nr.2090/2021 i datës 05.0.2021, gjykata vërtetojë faktin se paditësi është në marrëdhënie pune te e padituera, D.K.A., respektivisht në Institucionin Arsimor : shkolla H.” në fshatin R., komuna e Gjakovës.

Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU ”E.” me Nr.protokollit 2155/2022 i datës 16.05.2022, provon rrethanën se këtu paditësi punon në institucionin e lartpërmendur, dhe njëjta nga data 15.11.2019 e deri me datëb 29.10.2021, ka vijuar 208 ditë pune.

Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “At Gj.” në fshatin B., K. Gjakovë, me Nr. prot.1782/2022 të datës 16.05.2022 provon rrethanën se këtu paditësja punon në institucionin e lartpërmendur, e njëjta nga data 15.11.2019 deri me datë 29.10.2021, ka të mbajtura 139 ditë pune.

Certifikata e vendbanimit me nr. B10310427, e lëshuar nga Zyra e Qendrës Civile në Gjakovë, provon faktin se paditësi jeton në Gjakovë, në adresën : rruga “Nëna Tereza”.P.nr.

Vërtetimi i lëshuar nga Shoqata e Transportit të Udhëtareve “SHTU”, provon faktin se çmimi i biletës nga Gjakova për në fshatin B., në një drejtim kushton 0.50 cent.

Me nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit me nr. 01B-2056 e datës 18.04.2017 dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës 01/B e cila ka hyrë në fuqi me datën 22.01.2021, në mënyrë identike parashihet se *“Të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore.*

Gjykata nga administrimi i provave të cilave prova dhe ja fali besimin e plot, gjeti se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura, respektivisht në Shkollën Fillore” E.” në Gjakovë, dhe se për periudhën kohore nga data 15.11.2019 e deri me datën 29.10.2021, në këtë institucion arsimorë ka vijuar 208 ditë të pranisë në punë, provuar sipas vërtetimit Nr.protokollit 2155/2022 i datës 16.05.2022,të lëshua rnga po ky institucion arsimor. Njashtu paditësi është në marrëdhënie pune edhe në Shkollën Fillore “At Gj.” në fshatin B., komuna e Gjakovës, i cili në këtë institucion arsimore për peroidhn kohore të njëjtë, ka vijuar 139 ditë të pranisë në punë, fakt ky i vërtetuar sipas vërtetimit Nr. prot.1782/2022 të datës 16.05.2022. Duke u nisur nga fakti se e paditura, paditësit nuk i’u ka paguar shpenzimet e ushqimit e parapara me dispozita ligjor të lartçekura, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit bëri përlllogaritjen në atë mënyrë që, e ditët e kaluara në punë të paditësit, i ka shumëzuar me 2, duke i’au njohur shumen si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket kërkesës tjetër të paditëseve Rr.D., S.H. dhe T.H., të cilat i referohet shpenzimeve të udhëtimit, gjykata duke u bazuar në provat në të gjitha provat e lartcekura si dhe në nenin 35 parag. 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit e datës 18.04.2017 me të cilën është paraparë se:

“Mësimdhënësit që udhëtojnë në vendbanimet e Komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”, nenin 35 par. 5 të Kontratës Kolektive të si dhe të Kontratës së datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit për punonjësit arsimor, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e precizuar e paditësit edhe për këtë kompensimin (të shpenzimeve të udhëtimit) për periudhën kohore, 15.11.2019 – 29.10.2021, për 139 ditë të pranisë në punë është e themeltë. Kjo pasi që nga administrimi i provave u vërtetua se paditësi jeton nw Gj., në adresën rruga..., provuar sipas certifikata e vendbanimit me Nr. B10310427, e lëshuar nga Zyra e Qendrës Civile në Gjakovë. Lartësinë e kërkesëpadiës lidhur me këtë kriter të kompensimit, gjykata e vërtetojë në bazë të vërtetimit të lëshuar nga Shoqata e Transportit në Gjakovë, ku lartësia e çmimit të biletës për relacionin nga vendbanimi i paditësit Gjakovë, për në vendpunimin e tij fshati B., në Shkollën “At Gj.” është 1,00 euro në ditë për të dy drejtimet. Andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit t bëri përlllogaritjen në atë mënyrë që, e ditët e kaluara në punë të paditësit, i ka shumëzuar me 70% te çmimit te biletës se trafikut urban, duke i’au njohur shumen si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, me rastin e vendosjes murr parasysh edhe nenin 90 paragrafi 5 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, me të cilin parashihet se: “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive*”. Sipas neneve të lartë cituara të Kontratë Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë detyrimi i punëdhënësit në rastin konkret i të paditurës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit e nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e cila prodhon efekt juridik ndaj punëdhënëses të cilët kanë të punësuar punëtorët që të drejtat e tyre burojnë nga ajo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditëses dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ato kontrata.

Sipas nenit 8 par. 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, është paraparë se: “*Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij*”. Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: “*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*”, prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditorit, përkatësisht këtu paditëseve, të ia paguajë vlerën e precizuar të kërkesëpadiës si dhe shpenzimet tjera aksesore, siç më detajisht është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, pretendimet e të paditurës se nuk ka planifikim buxhetor për këto kompensime, i gjen si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në asnjë normë ligjore të aplikueshme. Paditësja në rrugë gjyqësore ka filluar të realizoj një të drejtë ligjore që i garanton Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë me nr. 01B-2056 e datës 18.04.2017 dhe ajo e viti 2021 kurse mungesa e buxhetit të paditurës, nuk mund të ketë për efekt vendosje ndryshe si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatëvonesën gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku parashihet se “*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debitor, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën*”, tutje paragrafi 2 i këtij neni parasheh se “*Lartësia e kamatëvonesës është 8% në vit, për veç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*”, andaj meqenëse e paditura ka rënë në vonesë në kompensimin e obligimit sa i përket kompensimit lidhur me shpenzimet e udhëtimit që ka pasur ndaj këtij paditëses, gjykata vlerëson se përpos kërkesës kryesore, të njëjtës i takon edhe kamata e gjykuar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën IV të dispozitivit, u muar sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së, me ç ‘rast paditësve iu pranua shume e shpenzimeve në vlerë prej 259,00€. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20,00€(e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 104,00€, si dhe përfaqësimin e të autorizuarit të paditësve në një seancë shumë të shumën prej 135,20€ të parapara sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 7).

Prandaj, gjykata, bazuar ne arsyet e cekura me larte, bazuar ne nenin 143 të LPK-së, vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.810/2021, me 17 maj 2022.

Gj y q t a r e,
Mirjeta Shala

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.